

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, si gjykatë civile e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit Makifete Saliuka, kryetare dhe Kujtim Pasuli e Nenad Llaziq, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit G.M. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim Z.I., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "D." në Prishtinë, me përfaqësuesin e autorizuar Xh.B., jur. i dipl., për shkak të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksident komunikacioni, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 515/2009, i datës 19.2.2013, në seancën e mbajtur me dt. 4.7.2016, mori këtë:

AKT GJYKIM

I. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 515/2009, i datës 19.2.2013, për kompensimin e pranuar paditësit G.M. nga Ferizaj, në pjesën që i referohet dëmit jomaterial për frikën e pësuar e në shumën e gjykuar prej 1.000,00 € sikurse edhe në pjesën që i referohet shpenzimeve të pranura të procedurës kontestimore, ndërsa **NDRYSHOHET** në pjesën që i referohet dëmit jomaterial për dhimbje fizike, i cili paditësit i pranohet në shumë prej 1.000,00 €, dhe kërkesës aksesore të paditësit për kamatëvonesë ligjore mbi shumat e gjykuara, ashtu që, të njëjtit, mbi shumat e gjykuara për dhimbje fizike dhe frikë - i pranohet kamatëvonesa ligjore nga dita e marrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht nga data 19.2.2013, e deri në pagesën definitive, sipas normës së kamatës të cilën e pranojnë bankat e Kosovës në mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar, nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

II. Aktgjykimi i goditur, në pjesën refuzuese të tij si në paragrafin II të dispozitivit të tij, mbetet i pa shqyrtuar - i tillë çfarë është.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e goditur, me paragrafin I të dispozitivit të tij, e ka MIRATUAR PJESËRISHT SI TË BAZUAR kërkesëpadinë e paditësit G.M. nga Ferizaj, dhe e ka DETYRUAR të paditurën Kompania e Sigurimeve "D." në Prishtinë, që paditësit, në emër të dëmit jo material, t'ia paguaj shumat si në vijim:

- për dhimbje fizike - 1.500,00 € dhe për frikën e pësuar - 1000,00 €,
- ashtu që shuma e tërësishme arrin vlerën prej 2500,00 €, me kamatë 3.5 %, si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, bashkë me shpenzimet e procedurës në shumë prej 558,00 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Ndërkaq, me paragrafin II, REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për dëmin jo material e mbi shumat e gjykuara dhe atë për dhimbje fizike - 500,00 € dhe për frikë - 500,00 €.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i konsideruar si tepër të larta shumat e gjykuara për paditësin për të cilat konsideron se duhet të zvogëlohen duke e ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, ose i njëjti të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës në pajtim me dispozitën e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se, me datën 4.3.2009, rreth orës 7,45 minuta, në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, në fshatin Prelez i Jerlive, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, kur i siguruari i të paditurës D.P., i cili ka qenë duke e drejtuar automjetin VW Golf CI, me targa 226-KS-760, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushtet në rrugë, ndërmerr veprimin për tejkalimin e automjetit para tij VW Golf 2, me targa ..., të cilin ka qenë duke e drejtuar këtu paditësi G.M., me ç'rast në pjesën e parë e godet majtas automjetin e paditësit, me ç' rast ky i fundit pëson lëndim trupor për çka trajtohet në Qendrën Emergjente – Spitali Ferizaj.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 19.2.2013, dhe pas vlerësimit të provave të siguruara nga ndërgjyqësit dhe gjykata, përfshirë këtu Mendimet e ekspertëve mjekësor, të dhëna sipas kërkesës së gjykatës, Dr. S.D., ortoped-traumatolog, dhe Dr. N.M., psikiatër, e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e detyruar të paditurën, që në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial t'ia paguaj shumat e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të goditur. Ekspertizën nga lëmi i komunikacionit nuk ka ngase baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit ka qenë jo kontestuese në mes të ndërgjyqësve.

Lidhur me natyrën e lëndimit që ka pësuar paditësi, gjykata e shkallës së parë vendimin e vet e ka mbështetur në Mendimin e ekspertit mjekësor Dr. S.D., ortoped traumatolog, i cili lëndimet e paditësit, i lindur në vitin 1982, i ka kualifikuar si lëndime të lehta trupore, që konsistojnë në "ndrydhje të regjionit të shpinës". Eksperti ka konstatuar dhimbjet e përjetuara fizike të paditësit si pasojë e lëndimit të pësuar, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre. Ka konstatuar se shëmtimin trupor nuk ka e as zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, por që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj në kohëzgjatje prej 7 ditësh dhe nevojë për ushqim të përforcuar për 7 ditë, ndërsa rehabilitimi i tij nuk ka qenë i nevojshëm. Ndërsa, ekspertja mjekësor Dr. N.M., psikiatër, ka dhënë vlerësimin e saj lidhur me frikën e përjetuar të paditësit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e saj.

Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të gjendjes faktike dhe duke u bazuar në mendimet dhe konstatimet e ekspertëve përkatës, ia ka pranuar paditësit kompensimin e dëmit në shumat e gjykuara, me kamatë vonesë ligjore 3.5% nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit, nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e në prani të faktit se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit është jo kontestuese, ndërsa aktgjykimi i goditur, nga e paditura është goditur vetëm sa i përket lartësisë së shumave të gjykuara, vlerëson se shuma e gjykuar në lartësi prej 1.500,00 € për dhimbje fizike që ka pësuar paditësi me rastin e aksidentimit vërtetë është e lartë, çka do të thotë se për këtë formë të dëmit është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për të cilën kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës

zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, prandaj, aktgjykimi i goditur në këtë pjesë ndryshohet në kuptim të nenit 201 par. 1 pika d) e LPK-së, ashtu që paditësit për dhimbje fizike i pranohet shuma e zvogëluar në lartësi prej 1.000,00 € - si shpagim i përafërt real për këtë formë të dëmit që ai ka pësuar si rezultat i lëndimit të marrë.

Edhe vendimi për kërkesën aksesore të paditësit që ka të bëjë me kamatën e pranuar mbi shumat e gjykuara në normën 3.5 %, ndryshohet në kuptim të nenit 201 par. 1 pika d) e LPK-së, nga fakti se i njëjti është marrë në kundërshtim me nenin 277 të LMD-së, ashtu që paditësit, mbi shumat e gjykuara nga 1.000,00 € - për dhimbje fizike dhe 1.000,00 € - për frikën e pësuar, i pranohet kamatë vonesa ligjore sipas normës së kamatës të cilën e pranojnë bankat e Kosovës në mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar nga data 19.2.2013 (*kur ka vendosur gjykata e shkallës së parë*) e deri në pagesën definitive.

Nga ana tjetër, aktgjykimi i goditur vërtetohet në pjesën ku paditësit i është pranuar shuma prej 1.000,00 €, për frikën e pësuar me rastin e aksidentimit, sepse kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se kjo shumë paraqet shpagim real për këtë formë të dëmit që ka pësuar paditësi, që mbështetën edhe me nenin 200 lidhur me nenin 189 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, duke marrë parasysh rëndësinë e të mirave të cenuara dhe qëllimin e kompensimit të dëmit, si satisfaksion real për dëmin.

Edhe vendimi për kërkesën aksesore të paditësit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore është i drejtë dhe i arsyetuar e në pajtim me nenin 452.1 lidhur me nenin 453 të LPK-së dhe Tarifën e Avokatëve të aplikueshme në Republikën e Kosovës, për faktin se i siguruari i të paditurës është ai që i ka dhënë shkas paditësit (*i cili konsiderohet si palë gjyqftuese*), për të iniciuar procedurën kontestimore, në të cilën janë shkaktuar shpenzime të konsiderueshme.

Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë as me shkelje tjera thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as atyre nga neni 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i goditur, në pjesën refuzuese të tij mbetet i pa shqyrtuar – i tillë çfarë është, nga se nuk është i goditur nga asnjëri prej ndërgjyqësve.

Për arsyet e paraqitura si më lart, Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 195 par. 1 pika d) lidhur me nenin 201 par. 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
AC.nr. 2484/13, datë 4.7.2016

KRYETARJA E KOLEGJIT-GJYKATËSJA,
Makifete Saliuka